



BEHXHET SH. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

LËVIZJA VETËVENDOSJE FITON ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT ME 49 PËR QIND TË VOTAVE

FAQE 4-5



Në Kosovë të dielën u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Të drejtë vote kishin 1 999 024 qytetarë. Sipas rezultateve preliminare, fituese e zgjedhjeve është LV-ja e Albin Kurtit, me mbi 49 për qind të votave të fituara, PDK-ja është e dyta me 21.18 për qind të votave, LDK-ja me 13.77 për qind, AAK-ja me 5.74 për qind dhe Lista Serbe me 3.86 për qind. Nisma Socialdemokrate, me vetëm 1.72 për qind të votave, nuk ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor. Bazuar në rezultatet preliminare, LV-ja pritet t'i ketë 56 ulëse në Kuvendin e Kosovës, PDK-ja 23 ulëse, LDK-ja 15 ulëse dhe AAK-ja 6 ulëse

BEDRI HAMZA:
PDK-ja KA RUAJTUR
ELEKTORATIN, KOSOVA
TË KETË INSTITUCIONE
SA MË PARË **F. 5**



TETË ANKESA
PËR SHKELJE
ZGJEDHORE
DORËZOHEN
NË PZAP **F. 7**



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË



Kolegji
BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



ZELENSKY ZOTOHET T'I VAZHDOJË
PËRPPJEKJET PËR PAQE PAS
"PËRPARIMIT" TË ARRITUR NË
TAKIMIN ME TRUMPIN **F. 2**

ISAK SHABANI U ZGJODH
KRYESUES I KUVENDIT KOMUNAL
TË PODUJEVËS **F. 6**

LUMEZI S'E PRANON PROPOZIMIN
PËR T'U BËRË ZËVENDËSKRYE-
PROKUROR I SHTETIT **F. 7**

EKONOMI



GUVERNATORI I BKQ-së: RRRITJE
EKONOMIKE 3.9 % NË VITIN 2025,
NË 2026-N PARASHIHET 4.1 % **F. 8**

FONDI PENSIONAL MBYLL VITIN ME
MBI 300 MILIONË EURO KTHIM NGA
INVESTIMET **F. 8**

SPORT



FFK-ja VENDOS, KUVENDI ZGJEDHOR
DO TË MBAHET MË 5 SHKURT 2026 **F. 10**

ZELENSKY ZOTOHET T'I VAZHDOJË PËRPPJEKJET PËR PAQE PAS “PËRPARIMIT” TË ARRITUR NË TAKIMIN ME TRUMPIN

KIEV, 29 DHJETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i përfundoi bisedimet me presidentin amerikan Donald Trump pa arritur ndonjë marrëveshje për paqe, por tha se ekipet amerikane dhe ukrainase do të takohen sërish së shpejti dhe se do të mbahet një takim i liderëve - përfshirë edhe ata nga Evropa - muajin e ardhshëm në Uashington. Zelensky shkroi më 28 dhjetor në rrjetet sociale se “patëm diskutim thelbësor për të gjitha çështjet”, përfshirë ato që lidhen me garancitë jetike të sigurisë, gjatë takimit në resorin Mar-a-Lago të Trumpit në Florida. “Biseduam për të gjitha aspektet e kornizës së paqes dhe arritëm rezultate të rëndësishme”, shkroi Zelensky. “Ne gjithashtu shtjelluam rendin e veprimeve të mëtejshme. U pajtuam se garancitë e sigurisë janë jetike në rrugën drejt arritjes së një paqeje të qëndrueshme”, shtoi ai. Takimi i Trumpit me Zelenskyn erdhi pas disa javëve të përpjekjeve të shtuara diplomatike për t'i dhënë fund pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia, i cili ka vlarë ose plagosur më shumë se 1.5 milion ushtarë në të dyja palët gjatë pothuajse katër vjetëve.

“Në drejtimin e duhur”

Pas dy orëve bisedime, Trumpi theksoi se bisedimet për paqen po “lëvizin në drejtimin e duhur”. Ai nuk përmendi mundësinë e pritjes së liderëve në Uashington në janar. “Po

afrohemi shumë, ndoshta shumë afër... [bisedimet po] lëvizin në drejtimin e duhur”, tha Trump. “Rusia dëshiron që [lufta] të përfundojë. Të gjithë duan që të përfundojë,” u tha ai gazetarëve pa dhënë hollësi. Trumpi dhe Zelensky zhvilluan edhe një bisedë telefonike me liderë evropianë, përfshirë presidentin francez Emmanuel Macron, kryeministrin britanik Keir Starmer, kancelarin gjerman Friedrich Merz dhe shefin e NATO-s, Mark Rutte. “Së bashku me disa liderë të tjerë evropianë, mora pjesë sonte në një shkëmbim me presidentët Zelensky dhe Trump”, shkroi Macron në rrjetet sociale. “Më pas fola [veçmas] me presidentin Zelensky”. “Po bëjmë përpërim për garancitë e sigurisë që do të jenë qendrore për ndërtimin e një paqeje të drejtë dhe të qëndrueshme”, shtoi ai. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, shkroi në rrjetet sociale se “Evropa është e gatshme të vazhdojë të punojë me Ukrainën dhe partnerët tanë amerikanë... thelbësore për këtë përpjekje janë garancitë e hekurta të sigurisë [për Ukrainën] që nga dita e parë”. Kiev ka qenë i palëkundur në kërkesën për garanci sigurie, veçanërisht nga Shtetet e Bashkuara, por edhe nga Evropa, si dhe ka kundërshtuar kërkesat e ashpra të Kremlinit, të cilat përfshijnë dorëzimin e territoreve ukrainase Rusisë. Gjatë konferencës së përbashkët për shtyp, Trump tha se çështjet

territoriale - përfshirë të ardhmen e rajonit Donbas të Ukrainës - nuk janë zgjidhur. “Është e pazgjidhur, por jemi afër. Kjo është një çështje shumë e vështirë”, tha Trump.

Zemërimi i Trumpit

Trumpi, i cili gjatë fushatës zgjedhore kishte thënë se do të mund t'i jepte fund luftës brenda një dite, është shprehur i zemëruar nga pamundësia për të përdorur atë që ai e sheh si zgjuarsinë e tij prej biznesmeni për t'i dhënë fund konfliktit më të përgjakshëm të Evropës që nga Lufta e Dytë Botërore. Ai ka çuar të dërguarin e tij kryesor, Steve Witkoff, në Moskë gjashtë herë për t'u takuar me presidentin rus Vladimir Putin. Vetë Trump u takua me liderin rus në Alaskë në gusht. Witkoffi, sekretari i Shtetit Marco Rubio, dhëndri i Trumpit, Jared Kushner, dhe shefi i Mbrojtjes, Pete Hegseth, morën pjesë në takimin e Trumpit me Zelenskyn, i cili ishte i treti për presidentin ukrainas me presidentin amerikan që nga janari.

“E gjithë bota”

Rusia nuk e bëri ndonjë koment thelbësor pas takimit dhe konferencës për shtyp Trump - Zelensky. I dërguari special i Putinit, Kirill Dmitriev, shkroi në rrjetet sociale se “e gjithë bota i vlerëson përpjekjet për paqe të presidentit Trump dhe ekipit të



tij”. Pak para fillimit të bisedimeve, Trumpi dhe Putini folën në telefon, një telefonatë befasuese që Kremlini tha se zgjati më shumë se një orë dhe u bë me kërkesë të Trumpit. Në një postim në rrjetet sociale, Trumpi e përshkroi atë si “të mirë dhe shumë frytdhënëse”. Këshilltari kryesor i politikës së jashtme të Putinit, Yury Ushakov, tha se Putini dhe Trumpi u pajtuan të mos mbështesin ndonjë shtysë për armëpushim të përkohshëm para një marrëveshjeje përfundimtare, diçka që Zelensky e ka kërkuar. Muajin e kaluar, Shtëpia e Bardhë propozoi një plan me 28 pika, i cili u cilësua si shumë i leverdishëm për Rusinë. Zelensky dhe negociatorët e tij - së bashku me aleatët evropianë të Kievit - kanë kërkuar të hartojnë kundërpropozime. Plani me 20 pika i Zelenskyt, i publikuar javën e kaluar, hapi rrugën që lideri ukrainas të udhëtonte drejt Shteteve të

Bashkuara dhe të takohet me Trumpin.

Pak shenja kompromisi

Mes diplomacisë dhe negociatave, Rusia ka treguar pak prirje për të lëshuar pe, duke mos pranuar madje as ta shqyrtojë një armëpushim për Krishtlindje të propozuar nga Zelensky. Një ditë para bisedimeve, Rusia bombardoi kryeqytetin ukrainas dhe qarqet përreth, duke lënë pothuajse 1 milion shtëpi pa energji elektrike në një kohë acari. Në një tjetër shenjë të qartë, Putin u takua me komandantë të lartë ushtarakë, duke lavdëruar sukseset në fushëbetejë, duke pretenduar se Ukraina ishte fajtorë për luftën dhe duke treguar se nuk e ka asnjë qëllim për të lëshuar pe. Nëse Kiev nuk dëshiron “ta zgjidhë çështjen në mënyrë paqësore”, Rusia do t'i arrijë synimet e saj me forcë, tha Putin, duke përsëritur komente që i ka bërë disa herë gjatë javëve të fundit.

ANIJE SHKATËRRUESE, AVIONË BOMBARDUES DHE DRONË, KINA KËRCËNON ME STËRVITJEN USHTARAKE RRETH TAJVANIT

PEKIN, 29 DHJETOR - Kina filloi të kryejë stërvitje ushtarake “në shkallë të gjerë” në ujërat dhe hapësirën ajrore përreth Tajvanit të hënën, duke përfshirë përdorimin e armëve të gjalla, mes tensioneve në rritje për shkak të një shitjeje masive armësh nga Shtetet e Bashkuara në ishull, i cili tha se po vendoste ushtrinë e vet në gjendje përgjigjeje. Forcat e armatosura të Kinës kanë vendosur “anije shkatërruese, fregata, avionë luftarakë, bombardues dhe dronë” për ushtrimet, të cilat përfshijnë përdorimin e “zjarrit të gjallë kundër objektivave

detarë në veri dhe jugperëndim të Tajvanit”, tha Komanda e Teatrit Lindor e ushtrisë kineze rreth orës 11:40 të paradites (05:40 GMT). Nga ana e saj, Taipei njoftoi se kishte vendosur “forca” dhe se njësitë e saj ushtarake kishin “kryer një ushtrim reagimi të shpejtë”. Pekini e konsideron Tajvanin një pjesë integrale të territorit të tij dhe nuk e ka përjashtuar kurrë mundësinë e përdorimit të forcës ushtarake për të arritur ribashkimin me kontinentin. Tensionet në Ngushticë u rritën nga shitja e një pakete të madhe pajisjesh ushtarake në mesin e



dhjetorit nga Uashingtoni për Taipei, e dyta që kur Donald

Trump u kthye në Shtëpinë e Bardhë, me një vlerë totale prej

11.1 miliardë dollarësh. Është paketa më e shtrenjtë e pajisjeve ushtarake e njoftuar që nga viti 2001. Qeveria kineze reagoi javën e kaluar duke njoftuar sanksione ndaj 20 industrive të mbrojtjes amerikane. Shfaqja në shkallë të gjerë e forcës vjen gjithashtu pas javësh tensionesh dhe debatesh diplomatike midis Pekinit dhe Tokios për ishullin, pasi kryeministrja e re Sanae Takaichi la të kuptohet në nëntor se vendi i saj do të ndërhynte ushtarakisht nëse Tajvani sulmohej - një deklaratë që zemëroi Pekinin.

ÇKA TASH?!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Zgjedhje me asnjë të panjohur: Sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, fituese absolute të shqiptarët është LV-ja, përkatësisht Albin Kurthi, kurse te serbët është Lista Serbe, përkatësisht Aleksandar Vuçiqi. Humbës janë LDK-ja, PDK-ja dhe të gjithë ata që, në një mënyrë apo tjetër, kanë sakrifikuar për këtë liri dhe këtë copë shtet që e kemi. Nuk thuhet kotë se idealistët e bëjnë luftën, kurse maskarenjtë e marrin pushtetin! Nëse i bëhet një skanim kohës dhe proceseve, që nga Rilindja Kombëtare e deri më sot, lehtësisht vërtetohet thënia e mësipërme. Në Shqipëri atdhetarët që e shpallën pavarësinë u përndoqën deri në asgjësim nga komunistët e Beogradit përmes piunit të tyre, Enver Hoxhës, në Shqipëri. Shumica e atdhetarëve në Shqipëri ose u vranë ose u arrestuan nga regjimi komunist i Enver Hoxhës. Prandaj nacionalizmi dhe atdhetarët deri më sot nuk e morën veten në Shqipëri. “Atdhetarët” e sotëm në Shqipëri, në krye me Sali Berishën, janë “bruto prodhim” i Partisë së Punës së Shqipërisë dhe shokut Enver. Edhe në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore ishte i njëjti film: nacionalistët dhe atdhetarët shqiptarë u vranë dhe arrestuan nga komunistët jugosllavë dhe serbë përmes atyre që flisnin shqip si: Fadil Hoxha, Ali Shukria, Kolë Shiroka etj. Sot vazhdimësia e tyre politike dhe kombëtare janë në pushtet në Kosovë. Pjesa dërrmuese e tyre, gjithsesi.

Pse ndodhi kështu: Nëse nuk keni investuar asgjë për liri dhe pavarësi, nuk ia dini vlerën, shtetin e shfrytëzoni si mundësi për të marrë pushtet. Çdo gjë që keni e shfrytëzoni për marrje

dhe mbajtje të pushtetit. Këtë e bëri pikërisht VV-ja që nga zgjedhjet e para. Kur e fitoi pushtetin absolut (për faje të opozitës që e rrëzuan qeverinë në kohë të pandemisë) në vitin 2021, VV-ja nuk la gjë pa bërë për të krijuar një infrastrukturë për të fituar zgjedhjet e radhës përmes shpërdorimit të buxhetit për blerje të votave. Kjo sidomos u theksua në zgjedhjet e 28 dhjetorit ku, brenda një kohe të shkurtër u futën në lojë mbi 300 milionë euro për kategoritë që potencialisht përbëjnë afërsisht 450.000 votues (studentë, prindër të fëmijëve dhe pensionistë). Kur kësaj i shtohen biletat e aeroplanit dhe mjeteve tjera të transportit të siguruara për diasporën nga qeveria dhe burimet tjera informale, trupi votues bëhet edhe më i madh. Propaganda e rreme populiste dhe “patriotike” te votuesit josakrifikues pati efektin e kompensimit të asaj që kurrë nuk e kanë pasur - dashurinë për kombin dhe atdheun. “Çlirimi” i Veriut ishte karremi tjetër për votuesit e painformuar. Vazhdoj të jem i sigurt se pikërisht veriu është “Thembra e Akilit” për Kosovën dhe se çdo marrëveshje me Serbinë, veriu paraqet xhoker dhe Kosovës do t’i varet si Shpata e Demokleut mbi qafë. Krahاسimi i opozitës me Listën Serbe në kohën kur VV-ja kurrë nuk e ka ndalë bashkëpunimin përmes sekseres Kusari ka ndikuar shumë në rezultatin e zgjedhjeve të fundit. Bllokimi i qëllimshëm i formimit të institucioneve nga VV-ja sikur edhe i marrëveshjeve ndërkombëtare, gjithashtu nga VV-ja nuk u shfrytëzua nga opozita prandaj VV-ja e shfrytëzoi këtë për ta fajësuar opozitën dhe votuesit e

pranuan këtë. Presidentja Vjosa Osmani 100 për qind ishte në shërbim të Kurthit dhe kundër opozitës sidomos kur caktoi, me kërkesë të Kurthit 28 dhjetorin. Opozita do të duhej ta refuzonte këtë datë me çmim edhe të bojkotimit të zgjedhjeve. Një opozitë e përgjegjshme do ta votonte kryetarin e Kuvendit të propozuar nga VV-ja që në seancën e parë sikur edhe qeverinë për t’u përgatitur për zgjedhjet e vitit 2026. Edhe PDK-ja dhe LDK-ja kanë bërë fushatë civilizuese dhe kanë pasur oferta të mira për votues që e duan zhvillimin dhe ardhmërinë. Mirëpo nuk kanë pasur resurse materiale për blerje të votave si VV-ja. Oferta e opozitës ka qenë për njerëz dhe votues të arsyeshëm, pjesa më e madhe e votuesve ishin kundër këtyre propozimeve, kundër arsyes, interesave të vendit dhe votën e shitën për 100 euro apo për një biletë aeroplani. Pasojat do t’i shohim më vonë kur të fillojë implementimi i Marrëveshjes së Brukselit dhe Ohrit që e federalizon Kosovën. Kurthi bëri një hap për afrimin me LS kur tha se kjo është parti politike e jo organizatë terroriste. Gjithashtu tha se ky është viti i normalizimit me Serbinë. Do të veprojë si me tokat që iu falen Manastirit të Deçanit. Si lakuriq i natës, bashkë me lakuriqen Shvarc brenda natës e bartën pronën duke e shitur si sukses. Kështu do të veprojë edhe me lëshimet e radhës që do të detyrohet t’i bëjë në emër të ruajtjes së pushtetit. Nuk do të ketë tjetër mundësi. Mund të taktizojë dhe blejë kohë deri sa të ketë luftë në Ukrainë, në Gaza apo Iran. Jo përtej saj.

Çfarë duhet të bëjë opozita: Po të ishte një opozitë angazhu

dhe aktive, shkak i skandaleve, keqpërdorimeve, varfërimit të skajshëm, Mafias Energjetike, ndërhyrje në punën e Prokurorisë, Gjykatave, asaj Kushtetuese në veçanti, nepotizmit, kapjes së çdo bordi, institucioni a ndërmarrjeve e shumë të tjera, opozita do duhej të protestonte 24 orë, çdo ditë të lume. Opozita do të duhej t’i votonte marrëveshjet ndërkombëtare pa pasur nevojë të takohet me Kurthin. Opozita nuk do të duhej që në asnjë mënyrë a formë të bëhet pjesë e “bisedimeve” me Serbinë. Realisht as që do të ketë bisedime që mund ta ndryshojnë përmbajtjen e marrëveshjeve, do të ketë “bisedime” për zbatim të këtyre marrëveshjeve. Opozita mund të provokojë zgjedhje në fillim të vitit 2026 nëse refuzon ta bëjë kuorumin për Vjosa Osmani. Kjo mundësi është në dorën e opozitës nëse vlerëson si të drejtë. LDK-ja gabimin më të madh e ka bërë me rastin kur ia siguroi kuorumin Vjosa Osmanit e cila pastaj edhe me votat e LS-së - e u zgjodh presidente. Askush nuk e ka dëmtuar LDK-në si Vjosa Osmani dhe Donika Shvarc duke e ndarë partinë në dysh dhe duke ia dhuruar Kurthit 100.000 vota të LDK-së si pajë elektorale. Nuk kam besuar se VV-ja fiton mbi 43 deputetë dhe se LDK-ja rrënohet aq shumë. Po ndodhi! Ky rezultat më shumë është barrë për VV-në se për opozitën. Gjithashtu, kurrë nuk kam besuar se ata që më shumë përshurën gjak se shurrë në burgjet jugosllave, që mblidhnin dhëmbët e thyer nga torturat e paraardhësve të një pjese të këtyre që janë në pushtet dhe votuesve të tyre, se

me muaj nuk i mbathnin këpucët që nga rrahjet brutale iu bënin si shputa të elefantit, që dilnin të gjymtuar seksualisht dhe fizikisht nga bastardët shqipfolës udbash të djeshit, pushtetarë të sotëm si vazhdim i valëzimit brutal antikombëtar do të përjetojnë kthimin në qeverisje të ish dhunuesve të tyre. Mos të flasim për mbijetuesit e masakrave, dhunimeve, të të zhdukurve gjatë luftës së fundit! Këta janë maskarenjtë e padënuar, nga Kurthi të graduar! Aspak nuk i besoj Albin Kurthit kur thotë se do të bisedojë me opozitën për vota për president. Ai do të bëjë çdo gjë për ta rizgjedhur Vjosa Odmanin presidente. Ku gjen më të bindur, më të paskrupullt dhe më manipuluese?! Përfutuese ordinere! Vrasëse e porositur nga Kurthi për eliminimin final të LDK-së. Bashkë me shpendkeqen Shvarc, e zezë si korb shpirtërisht. Rezultati i zgjedhjeve nuk mund dhe nuk duhet të kundërshtohen. Duhet të kundërshtohen pasojat që mund të prodhohen nga këto zgjedhje. Nëse Sali Berisha gati 80 vjeç po bënë opozitë aktive pse këtë nuk e bëjnë “tereqët” opozitarë duke u majmur në zyra! Nuk ka tregues më të mirë të qëndrimit të popullit dhe politikanëve se që çfarë qëndrimi mbajnë ndaj sakrifikuesve biblikë siç ishin Bacë Adem Demaçi dhe komandanti legjendar Adem Jashari. Të parin thuaja nuk e përmendin fare kurse të dytin gjatë fushatave zgjedhore dhe ndërtimit të ndonjë hoteli monumental në qendër të Prishtinës! Aty ku vdesë idealizmi, kurrë nuk lind patriotizmi!



LËVIZJA VETËVENDOSJE FITON ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT ME 49 PËR QIND TË VOTAVE

Në Kosovë të dielën u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Të drejtë vote kishin 1 999 024 qytetarë. Sipas rezultateve preliminare, fituese e zgjedhjeve është LV-ja e Albin Kurtit, me mbi 49 për qind të votave të fituara, PDK-ja është e dyta me 21.18 për qind të votave, LDK-ja me 13.77 për qind, AAK-ja me 5.74 për qind dhe Lista Serbe me 3.86 për qind. Nisma Socialdemokrate, me vetëm 1.72 për qind të votave, nuk ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor. Bazuar në rezultatet preliminare, LV-ja pritet t'i ketë 56 ulëse në Kuvendin e Kosovës, PDK-ja 23 ulëse, LDK-ja 15 ulëse dhe AAK-ja 6 ulëse

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatin preliminar të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe Lëvizja Vetëvendosje është fituesja e zgjedhjeve me 49.80 për qind të votave të fituara. Rezultatet preliminare u shpallën pas numërimit të 96.13 për qind të votave. Të drejtë vote kishin 1 999 024 qytetarë dhe dalja në zgjedhje ishte 45 për qind.

Kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se pjesa tjetër e votave do të procesohet dhe publikohet në platformën online të KQZ-së. Sipas rezultatit preliminar, PDK-ja është e dyta me 21.18 për qind të votave, LDK-ja me 13.77 për qind, AAK-ja me 5.74 për qind dhe Lista Serbe me 3.86 për qind. Nisma Socialdemokrate, me vetëm 1.72 për qind të votave, nuk ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor. Bazuar në rezultatet preliminare, LV-ja pritet t'i ketë 56 ulëse në Kuvendin e

Kosovës, PDK-ja 23 ulëse, LDK-ja 15 ulëse dhe AAK-ja 6 ulëse. Ndërkaq, shpallja e rezultateve përfundimtare do të bëhet pas numërimit të votave të diasporës, të personave me nevoja të veçanta dhe votave me kusht. "Numërimi i votave të kandidatëve [për deputetë] dhe konfirmimi i votave për subjektet politike do të nisë nesër nga ora 12:00, pasi i gjithë materiali gjatë gjithë natës do të pranohet në qendrat komunale të numërimit, dhe numërimi do të nisë nesër dhe do të vazhdojë në ditë në vijim", ka thënë Radoniqi. Kreu i LV-së, Albin Kurti, shpalli fitoren në zgjedhjet e 28 dhjetorit dhe tha se kjo është fitorja "më e madhe në historinë e vendit". "Më 9 shkurt fitoi LV-ja me partnerët, më 28 dhjetor fitoi populli i Kosovës dhe Republika", është shprehur Kurti. Ai ka thënë se partia e tij është në rrugë që ta tejkalojë rezultatin e 14 shkurtit 2021, kur kishte fituar 50.2 për qind. Sipas tij, rezultati zgjedhor i së dielës kërkon që duhet të ecet përpara pa vonesa. "Sa më parë që certifikohen [rezultatet], aq më shpejt na duhet të krijojmë institucionet dhe të vazhdojmë

me punën e mirë", ka thënë Kurti. Legjislaturën e re Kurti tha se e pret Plani i Rritjes i BE-së në vlerë prej 880 milionë eurosh dhe tri marrëveshje me Bankën Botërore, që në total tha se arrijnë vlerën e mbi një miliard eurove. "Ftoj nga tash partitë opozitare për bashkëpunim në Kuvend për marrëveshjet ndërkombëtare dhe për projektligje të tjera", ka deklaruar ai. Kurti u pyet edhe për çështjen e presidentit. Ai tha se është herët të flitet për çështjen e zgjedhjes së presidentit të ri, duke theksuar se "sonte do të festojmë", por shtoi se me opozitën duhet të trajtohet kjo çështje, por edhe me presidenten aktuale, Vjosa Osmani, së cilës i skadon mandati në mars. Ai u pyet nëse do të negociojë me partitë opozitare për presidentin dhe që propozimin për president ta bëjnë ato, Kurti tha: "Ta negocioni dhe t'ua jepni atyre janë dy gjëra të ndryshme. Nuk mund të përdoren si sinonime, aq më pak në të njëjtën fjali. Natyrisht që duhet ta bisedojmë me opozitën këtë çështje. Por, paraprakisht duhet të diskutojmë për

marrëveshjet ndërkombëtare. Ai do të jetë një test i rëndësishëm për bashkëpunimin qeveri-opozitë në katërvjeçarin e ardhshëm. Po rikthesoj, fillimisht duhet ta presim certifikimin e rezultateve". Njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë për Radion Evropë e Lirë (REL) se zgjedhjet e 28 dhjetorit ia sollën partisë së kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, një fitore "spektakolare", të cilën ajo e arriti kryesisht falë "dobësive" të partive opozitare. "Kjo është një fitore spektakolare e Lëvizjes Vetëvendosje, të cilën ia ka dhuruar opozita me mungesën totale të ideve se si të ballafaqohet me popullizmin e fuqishëm të Kurtit", thekson analisti Artan Muhaxhiri për REL-in. Fitoren e LV-ë, politologu Dritëro Arifi e sheh si rezultat i disa faktorëve të ndërlidhur - "propagandës së fuqishme" që ka kjo parti, si dhe dobësive të partive opozitare të cilat nuk kanë arritur të jenë mjaftueshëm aktive dhe të prezantojnë ekspertizë. "Më e rëndësishmja është se qytetarët e kanë vërejtur mungesën e lidershit të

BEDRI HAMZA: PDK-ja KA RUAJTUR ELEKTORATIN, KOSOVA TË KETË INSTITUCIONE SA MË PARË

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka mbajtur të hënën një konferencë për medie, një ditë pas zgjedhjeve nacionale të 28 dhjetorit, në të cilën ka folur hapur për rezultatin zgjedhor dhe hapat e ardhshëm të PDK-së. Në fillim të konferencës, kryetari Hamza uroi partinë fituese për rezultatin zgjedhor dhe shprehu pritjen që procesi demokratik të përmbyllet me konstituimin e shpejtë të institucioneve të reja të vendit. “Kemi pritur rezultat më të mirë. Unë personalisht kam pritur rezultat më të mirë dhe PDK-së i nevojitet një rezultat

tjetër”, u shpreh Hamza, duke theksuar se Partia Demokratike e Kosovës ka arritur ta ruajë votën dhe elektoratin. Hamza apeloi për konstituimin sa më të shpejtë të institucioneve të reja. “Shpresoj që sa më parë të konstituohen institucionet. Vendi duhet të ketë institucione dhe të mos kemi më vakum institucional”, u shpreh ai. Kryetari Hamza shtoi se puna duhet të vazhdojë pa vonesë dhe bllokada të reja. “Mjaftueshëm kemi pasur vonesa dhe bllokada. Secili duhet ta bëjë punën e vet, edhe partitë që kanë fituar, edhe ne që mund të jemi në opozitë, ta



japim kontributin tonë brenda përgjegjësiave tona”, deklaroi Hamza. Në fund kryetari i PDK-së konfirmoi qëndrimin parimor të partisë për interesin shtetëror. “Gjithçka që është në interes të Kosovës, PDK do ta japë kontributin e vet, përfshirë edhe marrëveshjet ndërkombëtare”, përfundoi ai. Në këtë kontekst, Hamza bëri me dije se Partia Demokratike e Kosovës do të futet shpejt në procesin e saj zgjedhor të brendshëm, i cili do t'i përfshijë të gjitha nivelet e strukturave të partisë, në frymë demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

HARADINAJ: KOSOVA DO TË DOBËSOHET NË PLANIN E BRENDSHËM DHE TË JASHTËM

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, pas rezultatit të zgjedhjeve të 28 dhjetorit, ka vlerësuar se Kosova do të dobësohet më shumë dhe se do t'i përfitojnë armiqtë e saj. Ai ka thënë se gjatë gjithë fushatës zgjedhore janë përballur me shqetësime të shumta të qytetarëve, duke përmendur problemet që lidhen me energjinë, proceset integruese dhe zhvillimin ekonomik të vendit. “Gjatë gjithë kësaj kohe të fushatës jemi përballur me shqetësime të shumta të qytetarëve që nga kolapsi energjetik, ngecjet në proceset integruese euroatlantike,



posaçërisht në NATO, rënia e investimeve kapitale në gjithë vendin e lënien përgjysmë të

krejt projekteve të mëdha, shtrënjtimin enorm të jetesës e stagnimin e pagave e deri te

largimi në masë i të rinjve nga Kosova”. Më tej, Haradinaj ka thënë se, ndonëse rezultati i zgjedhjeve e zgjidh ngërçin institucional, ai nuk është i bindur se i njëjti adreson shqetësimet e qytetarëve. “Rezultati i këtyre zgjedhjeve e zgjidh ngërçin institucional, por kam frikë se nuk i zgjidh problemet e shqetësimet e qytetarëve. Kosova do të dobësohet në planin e brendshëm e të jashtëm e do të fitojnë armiqtë e saj”, ka shkruar Haradinaj në rrjetin social ‘Facebook’. Ai ka deklaruar se AAK-ja do ta respektojë votën e qytetarëve, njëkohësisht do të reflektojë për proceset e brendshme të

partisë. “Për ne zgjedhjet do të përfundojnë këtë pranverë, me zgjedhjet brenda Aleancës në të gjitha nivelet dhe me ringritjen tone”. Ndër të tjera, Haradinaj ka falënderuar simpatizantët dhe strukturat e AAK-së për angazhimin e tyre gjatë fushatës. “Nga zemra i falënderoj të gjithë votuesit, aktivistët e AAK-së dhe gjithë të tjerët nga çdo cilësi e përkatësi e posaçërisht kolegët nga Lista 129 me të cilët kemi garuar në një betejë aspak të lehtë e në kohë të papërshtatshme”. Në zgjedhjet e 28 dhjetorit AAK-ja arriti të sigurojë vetëm 5.68 % të votave, ose 49 mijë e 675 vota.

Abdixhiku: Do të jap dorëheqje nëse e kërkon Kuvendi i LDK-së

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, pas numërimit të mbi 90 % të votave, ka thënë se nuk ka arritur ta çojë LDK-në aty ku dëshironte. “Sot më duhet të pranoj se nuk kam arritur ta

çoj LDK-në aty ku duhet të jetë. Kemi bërë një fushatë dinjitoze, së cilës nuk i ka munguar asgjë në përmbytje, por ky është verdikti i qytetarëve, dhe para këtij verdikti përkulemi të gjithë”, deklaroi Abdixhiku në konferencë për medie.

Ai ka shtuar se do të japë dorëheqje nëse kjo i kërkohet nga Kuvendi i LDK-së. “Do ta thërras Kuvendin e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe para tij do t'i shpalojmë dhe shqyrtojmë të gjitha çështjet, përfshirë edhe përgjegjësinë time si kryetar i kësaj shtëpie

të demokracisë. Të gjitha janë në diskutim në Kuvendin e Përgjithshëm. Natyrisht, jap dorëheqje pa asnjë diskutim”. Lidhja Demokratike e Kosovës në zgjedhjet e 28 dhjetorit mori 13.79 për qind të votave.



partitë opozitare, si dhe të një personi që do të mund ta ndryshonte gjendjen”, thekson Arifi për REL-in. Fjalimi i Kurtit, kur e shpalli fitoren pas publikimit të rezultateve preliminare nga KQZ-ja, ishte “mjaft i kujdesshëm dhe i matur” në raport me partitë e tjera shqiptare, vlerësojnë vëzhguesit e zhvillimeve zgjedhore. Por, sipas tyre, sfidat të cilat e presin shumicën e re parlamentare, por edhe qeverinë e re, përfshirë edhe zgjedhjen e presidentit të vendit në pranverën e vitit 2026, nuk i lënë vend “arrogancës të Kurtit”, të cilën

ai e kishte shfaqur ndaj kundërshtarëve politikë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021 dhe atyre të 9 shkurtit 2025. “Nuk jemi mësuar ta shohim Kurtin në këtë mënyrë. Por, kjo është gjë pozitive. Mirëpo nga këndvështrimi im, gjuha e trupit e tradhtonte. Normalisht që gjuha ishte e fituesit, por nuk e kishte entuziazmin e fituesit”, thekson politologu Arifi për REL-in. Ai dhe analisti Muhaxhiri besojnë se Kurti, i cili pritet të jetë për herë të tretë kryeministër, mund ta krijojë qeverinë e re vetëm me partinë e tij dhe me pakicat joserbe. Një koalicion me një parti tjetër

shqiptare do të ishte rezultat i dëshirueshëm për Kurtin, vlerësojnë ata. Megjithatë, Muhaxhiri vlerëson se hendeku i krijuar ndër vite ndërmjet LV-së dhe PDK-së, frika e LDK-së se mund të humbë edhe më shumë elektorat në rast të një marrëveshjeje me LV-në, e bëjnë të pamundur një koalicion të LV-së me dy partitë më të mëdha opozitare, por edhe ndonjë mbështetje të këtyre partive si opozitë. “Do të jetë shumë vështirë që [Kurti] t'i bindë PDK-në dhe LDK-në që të qëndrojnë në sallë, për ta arritur kuorumin prej 80 deputetësh për zgjedhjen e

presidentit ose presidentes. LDK-ja dhe PDK-ja konsiderojnë që presidentja [Vjosa] Osmani, me shumë veprime të saj, i ka ndihmuar LVV-së”, theksoi Muhaxhiri për REL-in. Ai shtoi se refuzimi i bashkëpunimit ndërmjet partive politike për zgjedhjen e presidentit mund ta çojë sërish vendin në zgjedhje qysh në pranverë kur Osmanit t'i mbarojë mandati në prill. Politologu Arifi shpreh mendimin se në rast se Lëvizja Vetëvendosje e tejkalon rezultatin e vitit 2021, Kurti do ta shqyrtojë nëse ka nevojë edhe për një mandat të presidentes Osmani, apo synon

të propozojë një kandidat tjetër. Sipas tij, kornizat që përcaktohen për partitë politike opozitare shqiptare, në bazë të numrave të ulëseve të fituara në Kuvend, nuk u mundësojnë hapësirë të madhe për manovrim me rastin e zgjedhjes së presidentit në mandatin e ardhshëm. “Opozita do ta bëjë një kuazi-pragmatizëm, në këtë rast të detyruar, që të qëndrojnë në sallë, sepse alternativa tjetër janë zgjedhjet e parakohshme, në të cilat, nëse opozita del si problematike, atëherë zoti Kurti mund të fitojë 60-70 për qind të votave totale”, thekson Arifi për REL-in.

Në Prizren sekuestrohen dy armë dhe municion, ndalohen dy persona

PRIZREN, 29 DHJETOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka pranuar një informatë për të shtëna me armë zjarri në fushat e fshatit Muradem, Prizren. Pas marrjes së informatës, patrullat policore janë angazhuar në vendin e ngjarjes dhe kanë

arritur të ndalojnë një automjet në të cilin gjendeshin dy persona të cilët po tentonin të largoheshin nga zona. Gjatë kontrollit të automjetit dhe personave, policia ka gjetur dhe sekuestruar dy armë zjarri - pistoletë dhe

disa pako me municion. Në vendngjarje kanë dalë hetuesi kujdestar dhe njësia e forenzikës të cilët kanë kryer fotografimin e vendit si dhe sekuestrimin e armëve, municionit dhe gëzhgojave. Po ashtu, është sekuestruar edhe automjeti i

përfshirë. Lidhur me rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit, i cili ka urdhëruar inicimin e procedurës penale dhe ndalimin e të dyshuarve për 48 orë. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për garantimin



e sigurisë së qytetarëve dhe parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme.

RASHIQI THOTË SE KA HYRË NË KUVENDIN E KOSOVËS

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë e Nenad Rashiqit, parti serbe në Kosovë, ka thënë të hënën se me 4 600 votat e fituara në zgjedhjet e së dielës, e ka siguruar një ulëse në Kuvendin e Kosovës për katër vitet e ardhshme. “Këtë besim e përjetojmë si një nder të madh, por edhe si një detyrim që të jemi edhe më të fortë, edhe më të pranishëm dhe edhe më të përkushtuar ndaj interesave të qytetarëve”, tha kjo parti në një njoftim në “Facebook” një ditë pas ditës së zgjedhjeve. Më herët, të dielën në mbrëmje, Lista Serbe - partia kryesore e serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit - pretendoi se me 90 për qind të votave të fituara të komunitetit serb, i ka fituar të

gjitha 10 ulëset e rezervuara për komunitetin serb në Kuvend. Megjithatë, kryetari i kësaj partie, Zllatan Ellek, pretendoi se Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë e Rashiqit “ka marrë vota në mjedise ku serbët nuk jetojnë” dhe se janë të detyruar ta presin edhe vlerësimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës. Zyrtari i Listës Serbe, Igor Simiq, shtoi se po pritet edhe numërimi i votave me kusht, si dhe se janë në përpunim mbi 1 000 vota të personave të zhvendosur nga Kosova, të cilët, gjithashtu, kanë votuar në zgjedhjet e së dielës. Sipas rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Kosovës, Lista Serbe ka marrë rreth 41 800 vota. Nga subjektet serbe



në zgjedhje ka marrë pjesë edhe Aleanca Kosovare e Goran Marinkoviqit, e cila ka

fituar rreth 550 vota. Sipas uebsajtit të KQZ-së, numërimi në të gjitha komunat me shumicë serbe nuk ka përfunduar ende plotësisht. Edhe në zgjedhjet parlamentare të muajit shkurt të këtij viti Lista Serbe kishte pretenduar se i kishte fituar të gjitha dhjetë mandatet, por një mandat deputeti megjithatë përfundoi në duart e Rashiqit. Rashiqi ishte ministër për Komunitete dhe Kthim në qeverinë e kaluar të kryeministrit Albin Kurti, i cili e kishte emëruar në këtë pozitë pasi Lista Serbe i kishte braktisur institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022. Megjithatë, Lista Serbe këmbëngul në qëndrimin se Rashiqi nuk ka numër të mjaftueshëm votash për ta përfaqësuar komunitetin serb.

Lista Serbe e kishte kundërshtuar gjithashtu në Gjykatën Kushtetuese zgjedhjen e Rashiqit nënkryetar të Kuvendit tashmë të shpërbërë nga radhët e komunitetit serb, duke pretenduar se ishin shkelur Kushtetuta dhe Rregullorja. Ende pritet vendimi i Gjykatës lidhur me këtë çështje. Sipas Kushtetutës së Kosovës, një nga nënkryetarët duhet të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb. Nga ana tjetër, sipas Rregullores së Punës, kandidatin për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb e propozon shumica e deputetëve nga ai komunitet.

ISAK SHABANI U ZGJODH KRYESUES I KUVENDIT KOMUNAL TË PODUJEVËS

PODUJEVË, 29 DHJETOR - Isak Shabani do ta udhëheqë Kuvendin Komunal të legjislaturës së tetë të dalë nga zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Shabani, i cili nuk pati kundërkandidat, u zgjodh kryesues i Kuvendit me 21 vota për dhe 1 abstencion, ndërkohë që anëtarët e LDK-së nuk morën pjesë në votim. Në fillim të kësaj mbledhje, që është e dyta e kësaj legjislature, kryetari i Komunës, Shpejtim Bulliqi, i njoftoi anëtarët e Kuvendit me emërimet në ekzekutiv, e që disa prej tyre ishin zgjedhur anëtarë të Kuvendit në zgjedhjet e tetorit. Anëtarë më i moshuar i

Kuvendit, Isak Ejupi, i cili e udhëhoqi mbledhjen para se të zgjidhej kryesuesi Shabani, i njoftoi të pranishmit se duhet të bëhet zëvendësimi i anëtarëve të Kuvendit, si në vijim: Bahri Selimin e zëvendëson Abedin Zeka, Vigan Salihun e zëvendëson Avni Islami, Lirie Hotin e zëvendëson Qëndresë Hajrizi dhe Avni Fetahun e zëvendëson Ardi Hasani. Pas verifikimit të mandateve nga komisioni përkatës, anëtarët e rinj e dhanë betimin dhe e nënshkruan deklaratën e marrjes së mandatit. Më pas u ngrit Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit për kryesues në



përbërje të tre anëtarëve. Kryesues u zgjodh Isak Shabani nga radhët e PDK-së. Shabani i falënderoi anëtarët e Kuvendit për besimin e dhënë dhe u zotua se do ta ushtrojë këtë detyrë me përkushtim dhe përgjegjësi. “Këtë detyrë e kuptoj si shërbim ndaj qytetarëve dhe do të angazhohem maksimalisht që puna e këtij Kuvendi të jetë sa më transparente, ligjore dhe në interes të përgjithshëm”, tha ndër të tjera kryesuesi Shabani. Gjatë kësaj seance Kuvendi i ka zgjedhur edhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa në përbërje prej 9 anëtarëve.

Gazetarja e REL-it shpërblehet me çmim për raportim në ekonomi

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) e ka shpërblyer gazetaren e Radios Evropa e Lirë, Nadije Ahmeti, për raportim dhe shkrim për sektorin financiar në vend. Ahmeti mori çmim për shkrimin “Dritarja e investimeve: kredi të garantuara, por grante të pezulluara për diasporën”, në një ceremoni të hënën në

Prishtinë. BQK-ja tha se “ky vlerësim pasqyron cilësinë, saktësinë dhe qasjen tuaj profesionale, si dhe kontributin e dhënë në informimin e publikut mbi zhvillimet në sektorin financiar të Republikës së Kosovës”. Në shkrimin e saj për dritaren e investimeve, Ahmeti suksesin dhe sfidat me të cilat është

përballur kjo nismë e krijuar për t'i joshur investimet nga diaspora. Ky është çmimi i dytë që gazetarja veterane e REL-it e fiton sivjet. Në gusht ajo u shpërblye nga Caritas-i zviceran në Kosovë me çmim për shkrimin më të mirë, “Perimet vendore shkojnë jashtë, tregu mbushet me import”.



Sekuestrohen rreth 3 000 kg patate në Hodonoc të Kamenicës, shtetasi i Serbisë shoqërohet në stacion policor

Prishtinë, 29 dhjetor - Policia e Kosovës ka bërë me dije se njësia policore gjatë një pike kontrolli ka ndaluar një kombi me targa të Serbisë me vozitës shtetas i Serbisë dhe gjatë kontrollit ka gjetur dhe

sekuestruar rreth 120 thasë me patate, me peshë rreth 3 000 kg. Rasti ka ndodhur në Hodonoc të Kamenicës të shtunën në orën 21:10. “Njësia policore gjatë një pike kontrolli kanë ndaluar një kombi me

targa të Serbisë me vozitës mashkull shtetas i Serbisë dhe gjatë kontrollit kanë gjetur dhe sekuestruar rreth 120 thasë me patate me peshë rreth 3000 kg”, thuhet në njoftim. I dyshuari është shoqëruar në

stacionin policor dhe me vendim të prokurorit i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa mallrat janë dërguar në terminalin doganor për procedim të mëtejshëm.



LUMEZI S'E PRANON PROPOZIMIN PËR T'U BËRË ZËVENDËSKRYEPROKUROR I SHTETIT

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Ish-kryeprokurori i Shtetit i Kosovës, Aleksandër Lumezi, e ka hedhur poshtë një propozim për t'u bërë zëvendëskryeprokuror i Shtetit për shkak të, siç tha, angazhimeve të tjera profesionale.

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) tha të hënën se u njoftua nga Lumezi përmes një letre se ai nuk e dëshiron këtë pozitë pas propozimit të ushtruesit të detyrës së kryeprokurorit të Shtetit, Agron Qalaj.

Refuzimi i tij u bë vetëm disa orë para një mbledhjeje të Këshillit Prokurorial, ku pritej të votohej për emërimin e tij. “Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të përgjegjësisë dhe angazhimeve që kjo pozitë kërkon, kam arritur në përfundim se në këtë moment nuk do të jem në gjendje të pranoj këtë detyrë për shkak të angazhimeve të mia profesionale si prokuror në



Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe në Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve të të gjitha

niveleve”, thuhet në letrën e Lumezit.

Lumezi ka qenë kryeprokuror i Shtetit nga viti 2015 deri në

vitin 2022, kur i mbaroi mandati.

Propozimi për ta emëruar Lumezin në këtë pozitë vjen në

një kohë kur në Këshillin Prokurorial ndodhën polemika dhe ndryshime.

Javën e kaluar Qalaj u emërua ushtrues i detyrës së kryeprokurorit të Shtetit pasi Besim Kelmendi kishte dhënë dorëheqje.

Dorëheqja e Kelmendit erdhi disa ditë pasi Gjykata Supreme e anuloi vendimin e Këshillit Prokurorial për shkarkimin e tij, duke e quajtur të kundërligjshëm.

Kosova është pa kryeprokuror të Shtetit qëkurse Lumezit i mbaroi mandati më 2022.

Presidentja Vjosa Osmani nuk e dekretoi Blerim Isufajn për këtë pozitë kur Këshilli Prokurorial ia propozoi vite më parë, me arsyetimin se janë gjetur disa shkelje ligjore në procesin e përzgjedhjes.

Faktori ndërkombëtar kritikoi mënyrën e përzgjedhjes së Isufajt nga KPK-ja dhe, me raste, ka kërkuar që procesi të kthehet në pikën zero.

TETË ANKESA PËR SHKELJE ZGJEDHORE DORËZOHEN NË PZAP

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Tetë ankesa janë dorëzuar deri tani para Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për shkelje të pretenduara të rregullave gjatë ditës së votimit më 28 dhjetor 2025.

Në faqen e PZAP-së figurojnë gjashtë ankesa nga Lëvizja Vetëvendosje dhe nga një ankesë nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

LV-ja ka dorëzuar tri ankesa kundër LDK-së, për përdorim të pasurisë publike dhe shfrytëzim të pozitës për vota, dhe një për vendosje të materialit zgjedhor në publik. Gjithashtu, subjekti më i madh politik në vend ka depozituar dy ankesa kundër AAK-së për shkelje të heshtjes zgjedhore

dhe një kundër Listës Serbe për të njëjtën shkelje.

LDK-ja është ankuar në PZAP për përdorimin e fëmijëve gjatë fushatës nga LV-ja, kurse kjo e fundit është akuzuar edhe për thyerje të heshtjes zgjedhore nga AAK-ja.

Zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit i fitoi Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit, duke i hapur rrugën për formimin e qeverisë së re.

Me pothuajse të gjitha votat e rregullta të numëruara, LV-ja ka fituar 49.30 për qind, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës me 21.01 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës me 13.59 për qind dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 5.68 për qind. Ndërkaq Lista Serbe - e afërt me Beogradin - fitoi 4.74 për qind të votave.



Vazhdojnë mesazhet mashtruese, Posta e Kosovës u bënë thirrje qytetarëve për kujdes

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Posta e Kosovës ka njoftuar qytetarët për një valë të re të mesazheve mashtruese që qarkullojnë përmes SMS-ve, ku palë të panjohura paraqiten në

emër të Postës së Kosovës. Sipas njoftimit të institucionit, menjëherë pasi është bërë me dije për rastet, Posta i ka informuar organet kompetente dhe po bashkëpunon me to për

hetimin e sulmeve.

Posta e Kosovës u bënë thirrje qytetarëve që të jenë të kujdesshëm dhe të mos klikojnë asnjë link të dërguar përmes këtyre mesazheve si dhe të mos

bashkëpunojnë me numra telefonikë që nuk i përkasin Postës. “Në asnjë rast Posta e Kosovës nuk do t’ju kërkojë të dhëna personale apo informacione bankare”, thuhet në njoftim.



Dhoma e Tregtisë uron LV-në për fitoren dhe kërkon fokus në sfidat ekonomike

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës (DhTIK) ka përsëritur përmbylljen e suksesshme të procesit zgjedhor dhe demokratik në Republikën e Kosovës. “Në emër të komunitetit të biznesit, i urojmë fitore fituesit të zgjedhjeve, Lëvizjes Vetëvendosje dhe kryeministrit,

z. Albin Kurti dhe i dëshirojmë suksese në udhëheqjen e institucioneve të vendit”, thuhet në reagimin e Dhomës së Tregtisë. DhTIK ka shprehur pritjet për formimin e shpejtë të institucioneve dhe për orientimin e qeverisë së re drejt ekonomisë. “DhTIK pret formimin e shpejt të

institucioneve të reja dhe që qeveria e re të ketë fokus në tejkalimin e shumë sfidave me të cilat është duke u përballur ekonomia”, thuhet më tej. Në reagim theksohet edhe gatishmëria për bashkëpunim me institucionet shtetërore. “Dhoma mbetet e përkushtuar në vazhdimin e angazhimit të saj tradicional të qenit një

partner aktiv dhe konstruktiv i institucioneve në të mirë të zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës”, vlerëson DhTIK. Sipas Dhomës së Tregtisë, bashkëpunimi mes qeverisë dhe sektorit privat është thelbësor për zhvillimin ekonomik. “Besojmë shumë se dialogu i hapur ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat



është çelësi për një Kosovë më të fortë ekonomikisht dhe më të qëndrueshme për qytetarët e saj”, përfundon reagimi.

FONDI PENSIONAL MBYLL VITIN ME MBI 300 MILIONË EURO KTHIM NGA INVESTIMET

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) ka njoftuar se deri më 24 dhjetor 2025 ka realizuar një kthim bruto nga investimet prej 312 milionë eurosh, duke e bërë vitin 2025 një nga më të suksesshmit në historinë e institucionit. Sipas njoftimit, meqë për vitin 2024 kthimi bruto nga investimet ishte rreth 244 milionë euro, rezultoi se vetëm në dy vitet e fundit FKPK-ja ka akumuluar kthim bruto nga investimet rreth 556 milionë euro. FKPK thekson se ky ishte “viti i 21-të nga gjithsej 24 vjet të operimit të FKPK-së, që institucioni arrin kthim vjetor pozitiv nga investimet”, ndërsa “kthimi i akumuluar bruto, prej themelimit e deri në këtë datë të raportimit, ka arritur në rreth 1.3 miliard euro”. Në njoftim bëhet me dije se edhe arkëtimi i kontributeve të reja ka shënuar rritje të ndjeshme. “Arkëtimi i kontributeve të reja në 2025-shin, aktualisht në vlerë prej 354 milionë euro, pasqyron një



ngritje solide, si në vlerë nominale (prej +36 milionë euro) ashtu edhe në përqindje, prej 12 % nga viti paraprak”, thuhet në njoftim. Si rezultat i kontributeve të reja dhe kthimit nga investimet, FKPK njofton se vlera neto e mjeteve nën

menaxhim për këtë vit aktualisht është ngritur për rreth 569 milionë euro, duke qenë larg ngritja më e shpejtë ndonjëherë e mjeteve nën menaxhim të FKPK-së. Sa i përket Portofolit Standard, FKPK bën me dije se “performanca e investimeve

për vitin 2025 është +9.14 %”, duke theksuar se ky portofol “ka arritur ta tejkalojë dukshëm inflacionin në vend”. Në njoftim thuhet se kjo performancë i atribuohet si vlerësimit pozitiv të indekseve kryesore të tregjeve financiare, po ashtu edhe alokimeve

taktike të FKPK-së, veçanërisht përqendrimit në sektorin e teknologjisë së informacionit. Megjithatë, FKPK paralajmëron kujdes për vitin e ardhshëm. “Në vitin 2026 FKPK-ja do ta mirëmbajë vigjilencën, ngaqë trajektorja rritëse e vitit 2025 mund të ballafaqohet me pengesa nga vlerësimet e larta dhe normat e vazhdueshme të inflacionit”, thuhet tutje në njoftim. Ndërkohë Portofoli i Balancuar për vitin 2025 ka shënuar rritje prej “+8.97 %”, ndërsa Portofoli Konservativ ka pasur një performancë prej “+3.43 %”, me fokus në mbrojtjen e kursimeve për pjesëmarrësit e moshës 63 vjeç e sipër. Në përfundim, FKPK vlerëson se të tre portofolat investues, përgjatë këtyre dy vjetëve të funksionimit, kanë dhënë shenja tejet inkurajuese, duke ritheksuar se do ta vazhdojë strategjinë e saj afatgjatë të investimeve, të kombinuar me veprime taktike në varësi të zhvillimeve globale.

GUVERNATORI I BKQ-së: RRRITJE EKONOMIKE 3.9 % NË VITIN 2025, PËR 2026-N PARASHIHET 4.1 %



PRISHTINË, 29 DHJETOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK), nën drejtimin e guvernatorit Ahmet Ismaili, ka publikuar të dhënat kryesore ekonomike të vendit për vitin 2025, duke evidentuar një rritje pozitive dhe stabilitet financiar të qëndrueshëm. Sipas raportit të BQK-së, ekonomia e Kosovës është rritur me 3.9 përqind gjatë këtij viti, me kontribuese kryesore konsumin e brendshëm, eksporte në rritje dhe flukset e qëndrueshme të remitencave.

Guvernatori Ahmet Ismaili theksoi se “trendët e stabilitetit financiar dhe rritjes ekonomike tregojnë forcën e ekonomisë kosovare, pavarësisht sfidave globale”. Për vitin 2026 BQK-ja parashikon rritje ekonomike prej 4.1-përqindësh, e nxitur nga investimet dhe përmirësimi i aktivitetit ekonomik. Remitencat vazhdojnë të kenë rol kyç në mbështetjen e konsumit, me një vlerë të pritshme prej 1.4 miliard eurosh

deri në fund të vitit. Raporti, gjithashtu, evidenton një trend të rritjes së investimeve të huaja direkte, të cilat pritet të kontribuojnë më tej në zhvillimin e ekonomisë dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Guvernatori Ismaili theksoi se “synimi ynë mbetet ruajtja e stabilitetit financiar dhe krijimi i kushteve për një rritje të qëndrueshme, duke nxitur besimin tek ekonomia kosovare dhe partnerët investues”.

KOSTT-i thotë se sistemi elektroenergjetik i Kosovës është stabil

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) ka bërë me dije se sistemi elektroenergjetik i Kosovës është stabil dhe po operon në mënyrë të sigurt, bazuar në monitorimin e vazhdueshëm të

gjendjes në sistem pavarësisht prej rritjes së ngarkesës së regjistruar ditëve të fundit. Sipas KOSTT-it, vetëm në zonën e Rahovecit është aplikuar një kufizim i përkohshëm rreth 5MW, ndërsa në pjesët e tjera të sistemit nuk është aplikuar asnjë kufizim i

ngarkesës. “KOSTT vazhdon menaxhimin e sistemit në kohë reale, me masa operative të koordinuara, për ta ruajtur stabilitetin dhe për të siguruar furnizim sa më të qëndrueshëm për konsumatorët. U bëjmë thirrje qytetarëve që ta përdorin

energjinë elektrike në mënyrë të përgjegjshme dhe racionale, sidomos në orët e pikut, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të sistemit dhe sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm për të gjithë konsumatorët”, ka njoftuar KOSTT-i.



IL DIVO - ANATOMIA E PUSHTETIT TË HESHTUR TË GIULIO ANDREOTTI



Giulio Andreotti nuk ishte produkt i karizmës, por i institucioneve. Në një sistem të ndërtuar mbi ekuilibra të brishtë, ai u bë njeriu i stabilitetit. Ndërsa të tjerët grindeshin në ekranet televizive, Andreotti negocionte në korridore. Ndërsa të tjerët kërkonin duartrokitje, ai kërkonte kohë. Ishte politikë pa spektakël, por me kujtesë të gjatë. Dhe siç thoshte ai: "Pushteti konsumon atë që nuk e ka...

Në një vend ku politika ka prodhuar tribuna, skandale dhe figura teatrale, Giulio Andreotti ishte përjashtimi absolut. I vogël në shtat, me shpinë paksa të përkulur, zë të ulët dhe ironi therëse, ai arriti diçka që pak politikanë në Evropën e pasluftës e kanë bërë: të sundojë pa u dukur. Ish Kryeministri italian nuk premonte dhe nuk i entuziazmoi kurrë turmat. Dhe megjithatë, për dekada të tëra në Itali, asgjë e rëndësishme nuk lëvizte pa kaluar, në një mënyrë a tjetër, përmes tij. Kështu lindi nofka Il Divo. Jo për madhështinë morale, por për paprekshmërinë. Giulio Andreotti nuk ishte produkt i karizmës, por i

institucioneve. Ai u formua në zemër të Demokracisë Kristiane, partisë që qeverisi Italinë pothuajse pa ndërprerje pas Luftës së Dytë Botërore. Në një sistem të ndërtuar mbi ekuilibra të brishtë, ai u bë njeriu i stabilitetit. Ndërsa të tjerët grindeshin në ekranet televizive, Andreotti negocionte në korridore. Ndërsa të tjerët kërkonin duartrokitje, ai kërkonte kohë. Ishte politikë pa spektakël, por me kujtesë të gjatë.

Realpolitikë italiane

Për Andreottin, politika nuk ishte një betejë mes së mirës dhe së keqes. Ishte menaxhim frike.

Frikë nga komunizmi. Frikë nga kaosi social. Frikë nga prishja e ekuilibrit ndërkombëtar. Në kontekstin e Luftës së Ftohtë, Italia ishte një pikë nevralgjike: një vend perëndimor me një parti komuniste të madhe. Dhe Giulio Andreotti u bë arkitekti i një vije të qartë që duhej ndjekur: Perëndimi, NATO, SHBA-ja. Jo si deklaratë ideologjike, por si garanci mbijetese për sistemin. Në këtë logjikë, kompromisi nuk ishte tradhti, por domosdoshmëri.

Heshtja si metodë

Giulio Andreotti fliste pak pikërisht sepse dinte shumë. Kur akuzat për lidhje me mafian nisën të dalin në dritë, ai nuk reagoi me zemërim. Nuk kërkoi rehabilitim moral publik. Ai bëri atë që dinte më mirë: priti. Proceset gjyqësore u zvarritën. Dosjet u trashën. Opinioni publik u lodh. Dhe ndërkohë, Andreotti mbeti po aty. Jo sepse u shpall hero, por sepse sistemi nuk dinte si ta rrëzonte plotësisht. Në fund, drejtësia

juridike foli ndryshe nga ajo morale. Asnjë analizë e Giulio Andreottit nuk është e plotë pa Vatikanin. Ai ishte ura e padukshme mes politikës laike dhe diplomacisë fetare. Në një Itali ku Kisha mbetej autoritet moral, Andreotti e kuptoi se legjitimiteti nuk fitohet vetëm me vota. Këto lidhje nuk ishin thjesht ideologjike. Ato ishin mbi të gjitha strategjike. Vatikani ofronte heshtje, ndikim dhe stabilitet. Andreotti, nga ana tjetër, ofronte mbrojtje institucionale.

"Pushteti konsumon ata që nuk e kanë"

Aforizmat e Andreottit janë më shumë se batuta. Ato janë manual i vërtetë për mënyrën se si duhet të sillesh me pushtetin. Ai besonte se ata që kërkojnë pushtetin me pasion, zakonisht nuk janë të denjë për të. Ndërsa ata që e trajtojnë si barrë, janë pikërisht ata që e mbajnë më gjatë. Giulio Andreotti nuk kishte

iluzione për natyrën njerëzore dhe ai nuk besonte te transparenca absolute. Për të, morali ishte luks që sistemi e përballon vetëm në kohë paqeje.

Tangentopoli dhe fundi i botës së vjetër

Skandalet e viteve '90 nuk rrëzuan vetëm individë. Ato rrëzuan një epokë. Republika e Parë italiane u shemb dhe bashkë me të, edhe terreni ku Andreotti kishte operuar me mjeshtëri. Ai nuk u rrëzua si një tiran. U tërhoq si një figurë e vjetër, që i kishte mbijetuar kohës së vet, por jo në botën e re mediatike, të shpejtë, të zhurmshme. Giulio Andreotti nuk është figurë për përmendore e as për rehabilitim sentimental. Ai është pasqyrë. Është pasqyra e një Italie që zgjodhi stabilitetin mbi idealizmin, heshtjen mbi përballjen, strukturën mbi moralin. Il Divo na kujton se pushteti më i fortë nuk është ai që bërtet, por ai që nuk ka nevojë të shpjegohet. / bota.al

PSE GRATË NË SPARTË DUHEJ TË MËSONIN TË ZHVESHURA (NDËRSA BURRAT SHIKONIN)



Historiani Andrew Bayliss paralajmëron komentuesit modernë që të mos e barazojnë me “çlirim” arsimin e detyrueshëm për gratë në Spartë.

Nga: Harry
SIDÉBOTTOM
(The Telegraph)


Spartanët gëzojnë një imazh të lartë në imagjinatën popullore moderne: të guximshëm dhe të bindur, i paramendojmë si luftëtarë të pathyeshëm për liri, me aftësi për fraza të zgjuara të denja për një film të Clint Eastwoodit. Por, realiteti, siç e thekson Andrew Bayliss në hyrje të historisë së tij interesante, Sparta: Ngritja dhe rënia e një superfuqie të lashtë [Sparta: The Rise and Fall of An Ancient Superpower], është shumë më i vështirë për t'u rindërtuar. Përveç disa qindra vargjeve të poetëve Tirteu dhe Alkman, të gjitha burimet tona të lashta janë shkruar nga grekë të tjerë, zakonisht athinas. Siç ka thënë Tukididi, detyra e këtyre të jashtëmëve bëhej edhe më e vështirë nga fshehtësia maniake e spartanëve. Një pengesë tjetër ishte ideologjia spartane se qyteti i tyre ishte i pandryshueshëm, gjë që e bën të vështirë ndërtimin e një narrative historike. Por, mbretëria spartane nuk ka qenë gjithmonë një fuqi ndërkombëtare. Ngjarja që e shtyu në këtë drejtim ishte pushtimi i Mesenisë fqinje në mesin e shekullit të shtatë para Krishtit (edhe pse mungesa e burimeve e bën këtë disi të paqartë). Ky aneksim i dha

Spartës një territor shumë më të madh se cilido qytet tjetër grek i përçarë nga grindjet e brendshme. Kryesorja, spartanët i ulën mesenianët, grekë si ata, në statusin e helotëve - zakonisht të përkthyer si “bujq të lidhur me tokën”, megjithëse “skllëvër” mund të jetë term më i përshtatshëm. Puna e helotëve ua mundësoi spartanëve të ndërtonin sistemin e tyre të ashpër dhe pederast të edukimit shtetëror, agoge, dhe të përkushtoheshin tërësisht për të qenë luftëtarë gjatë gjithë kohës. Ky sistem shërbeu edhe për të zgjidhur një debat, kur aleatët e Spartës u ankuan se po siguronin më shumë trupa për ushtrinë sesa vetë spartanët. Mbreti spartan, Agesilau, urdhëroi ushtarët e tij të uleshin: pastaj, për një nga një, kërkoi që të ngriheshin të gjithë ata që merreshin me ndonjë zanat - nga poçarët te farkëtarët. Pas pak, thujse të gjithë aleatët ishin në këmbë, ndërsa spartanët ishin ende ulur. “Shihni”, tha Agesilau, “se sa më shumë ushtarë dërgojmë ne krahasuar me ju”. Gratë spartane, në sytë e grekëve të tjerë, ishin më të çuditshme. Ato nuk kishin frikë të qortonin burrat publikisht, zakonisht për qyqarllëk. Kur djemtë nuk po tregonin zellin e pritur luftarak, një nënë spartane ngrinte fustanin dhe pyeste nëse donin të

ktheheshin aty nga kishin ardhur. Gratë ndiqnin versionin e tyre të agogësë dhe mund të zotëronin prona dhe toka. Më të pasurat madje dërgonin skuadra qerresh për të marrë pjesë në Lojërat Olimpike. Megjithatë, siç tregon Bayliss, kjo nuk duhet kursesi të çojë komentuesit modernë në përfundimin se gratë spartane ishin veçanërisht të “çliruara”. Ato ishin në thelb si makina për riprodhim. Agogëja e tyre ishte ndërtuar për t'i bërë të afta fizikisht dhe të shëndetshme për të lindur brezin tjetër të luftëtarëve spartanë; ishte e detyrueshme, dhe disa elementë të ushtrimeve, sipas burimeve të mëvonshme, kryheshin lakuriq teksa burrat qytetarë shikonin. (Plutarku pohon se kjo i nxiste burrat spartanë të martoheshin nga “nevoja dashurore”.) Është e njohur se një burrë spartan mund t'ia huazonte gruan e tij një qytetari tjetër për të pasur fëmijë. Asgjë në burimet tona nuk sugjeron se gruaja kishte ndonjë të drejtë fjale në këtë marrëveshje. Përveç fuqisë së luftëtarëve të saj, Sparta ishte veçanërisht e papërshtatshme për t'u bërë superfuqi, duke mbajtur që në fillim farat e rënies së vet. Sparta kishte dy mbretër, nga dy dinasti të ndryshme; ata shpesh grindeshin dhe përdroreshin nga qytetarët e pakënaqur për të sabotuar njëri-tjetrin - madje ndonjëherë për t'i përmbysur. Këshilli i pesë eforëve (magjistratëve kryesorë) ndërrohej çdo vit. Kështu,

zbatimi i një strategjie të qëndrueshme afatgjate ishte i pamundur. As në zonën e saj brenda Peloponezit, Sparta nuk ishte e sigurt. Kurrë nuk arriti ta nënshtronte rivalin e saj lokal - qytetin e Argosit që u bë qendër e kundërshtimit. Ekzistenca e helotëve gjithashtu shtonte pasiguri në politikën e jashtme. Nga njëra anë ishte argumenti se, meqë helotët kryenin punën duke u dhënë kohë spartanëve për t'u përkushtuar për të qenë ushtarët më të mirë në botë, Sparta do të duhej ta përdorte avantazhin e saj ushtarak për të ndërtuar një perandori. Nga ana tjetër, spartanët ishin plotësisht të vetëdijshëm se helotët i urrenin, donin “t'i hanin të gjallë”, prandaj qytetarët duhej të rrinin në shtëpi për t'i mbajtur nën kontroll. Por, problemi më i madh i Spartës ishte veçantia e saj. Ishte e lehtë të humbje statusin e qytetarit nëse dështoje në sprovat e agogësë, ose tregojë frikë në betejë. Nga ana tjetër, ngritja e të tjerëve në statusin e qytetarit ndodhte rrallë dhe vetëm në raste emergjencash të mëdha ushtarake. Kështu, me kalimin e kohës, numri i spartanëve ra me shpejtësi. Fillimisht, zyrtarët spartanë besonin se pas ndarjes së tokës së Mesenisë, kishin nëntë mijë homojojë (qytetarë elitare). Në betejën e Platesë më 479 para Krishtit, morën pjesë pesë mijë. Në Mantinea, më 418 para Krishtit, ishin vetëm pak më shumë se dy mijë dhe në Leuktra, më 371 para Krishtit, më pak se një mijë.

Dëmtues edhe më i madh për jetëgjatësinë e Spartës ishte zakoni i trashëgimisë së barabartë. Tokat e një qytetari duhej të prodhonin mjaftueshëm për të kontribuar në “mes” [darka e përbashkët e ushtarakëve]. Nëse një spartan kishte disa fëmijë, pas dhënies së pajës për vajzat ishte e mundshme që djemtë nuk do të trashëgonin tokë të mjaftueshme për të ruajtur statusin apo qytetarinë. Pasi Epaminonda nga Teba çliroi mesenianët më 369 para Krishtit - pavarësisht përpjekjeve për reforma radikale në shekullin III para Krishtit - Sparta mori fund si fuqi e madhe. Në kohët romake, ajo u shndërrua në një qytet turistik, një version “Diznilendi” i vetes së saj të dikurshme. Bayliss ofron një rrëfim tradicional politik dhe ushtarak, të shkruar me një gjuhë të lexueshme, dhe të informuar nga një lexim i ndjeshëm i burimeve të lashta dhe nga një njohje e thellë e studimeve moderne. Megjithatë, një kritikë e vogël i drejtohet botuesit. Lexuesit që duan të mësojnë më shumë për Spartën - dhe Bayliss do t'i frymëzojë shumë për ta bërë këtë - nuk shërbehen mirë me shënimet fund të librit, të cilat rrallëherë përmendin ndonjë studim bashkëkohor, ndërsa bibliografia e përzgjedhur është tepër e shkurtër. Shumë shpesh botuesit tremben se mos i frikësojnë lexuesit, duke i nënvlerësuar ata. Duhet t'u besojnë më shumë - ka apetit të mjaftueshëm për dije më të thella. /Telegrafi/



Mitaj nuk largohet nga Al-Ittihadi

RIAD, 29 DHJETOR - Mbrojtësi shqiptar i krahut të majtë, Mario Mitaj, nuk do të largohet nga Arabia Saudite, saktësisht skuadra e Al-Ittihadit. Drejtuesit e klubit saudit kanë hedhur

poshtë lajmin për shitjen e Mitajt gjatë afatit kalimtar të janarit, duke e quajtur spekulim. Tek Al-Ittihadi kanë insistuar se Mitaj është i rëndësishëm për ekipin dhe se nuk janë në

negociata me asnjë skuadër për shitjen e tij. Mitaj para një viti u transferua në Arabinë Saudite për katër milionë euro dhe me Al-Ittihadin ka kontratë deri në verën e vitit 2028. Ai tashmë ka

fituar titullin e kampionit dhe Kupën e Mbretit në Arabinë Saudite, ndërsa këtë sezon ka shënuar një gol dhe ka bërë dy asistime në 16 ndeshje të luajtura.



FFK-ja VENDOS, KUVENDI ZGJEDHOR DO TË MBAHET MË 5 SHKURT 2026

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Komiteti Ekzekutiv ka vendosur që Kuvendi Zgjedhor i Federatës së Futbollit të Kosovës të mbahet më 5 shkurt 2026.

Komiteti Ekzekutiv (KE) i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka mbajtur mbledhjen e fundit për këtë vit nën drejtimin e presidentit Agim Ademi. Rendi i ditës i kësaj mbledhje ishte aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, përmbyllja e vitit 2025, përgatitjet për procesin zgjedhor si dhe pika të ndryshme.

“Në lidhje me procesin zgjedhor, KE i FFK-së konstatoi



se përgatitjet për kuvendet zgjedhore në regjione janë duke u zhvilluar sipas dinamikës së paraparë. Në këtë kuadër, Komiteti Ekzekutiv vendosi që Kuvendi Zgjedhor i FFK-së të mbahet më 5 shkurt 2026”, është thënë në vendimin e KE të FFK-së.

Duke folur për vitin 2025, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka theksuar se ky vit ka qenë jashtëzakonisht i suksesshëm në të gjitha segmentet, me arritje historike për futbollin e Kosovës. Ai ka vlerësuar se viti është përmbyllur shumë mirë si në aspektin organizativ të

Federatës ashtu edhe me rezultatet e arritura nga Kombëtarja A dhe klubet e Kosovës në arenën evropiane. Presidenti Ademi ka potencuar rëndësinë e dy ndeshjeve të ardhshme të “play-off”-it të Kombëtares, duke theksuar se përqendrimi i plotë duhet të jetë në ndeshjen e parë ndaj Sllovakisë, me shpresën që Kombëtarja do të jetë në formën optimale në muajin mars dhe do t'i kalojë me sukses edhe këta dy hapa për ta realizuar ëndrrën e shumë gjeneratave për paraqitjen e parë historike në Kupën e Botës.

CLUJI INTERESOHET PËR ETNIK BRRUTIN



BUDAPEST, 29 DHJETOR - Pas largimit të Lindon Emërllahut nga Cluji, skuadra rumune duket se ka gjetur zëvendësimin e tij në Superligën e Kosovës. Është bërë me dije se Cluji ka shfaqur interesim për mesfushorin Etnik Brruti, i cili është pjesë e skuadrës së Malishevës. Brruti po shihet si zëvendësim ideal për Emërllahun, i cili ditë më parë u transferua në Ukrainë te

skuadra Polissya Zhytomur për gati dy milionë euro. Megjithatë, është thënë se Cluji duhet të ofrojë të paktën 800 mijë euro për ta bindur Malishevën në lirim të tij muajin tjetër, ndonëse ekipi i Kosovës kërkon të ruajë edhe 15 për qind të kartonit të tij. Brruti ka kontratë me Malishevën deri në fund të këtij sezoni, pra deri në qershorin e vitit 2026 dhe skuadra e

Kosovës nuk dëshiron ta humbë atë pa kompensim. 21-vjeçari këtë sezon ishte ndër lojtarët kryesorë të Malishevës, ekip që stinorin vjeshtor e ka përfunduar në pozitën e pestë në tabelë me 27 pikë, gjashtë më pak se Ballkani që dimëron si kampion. Në 17 ndeshje të luajtura këtë sezon për Malishevën, Brruti ka shënuar 4 gola dhe ka bërë tri asistime në të gjitha garat.

CAVANI I JEP FUND KARRIERËS SË TIJ TË SHKËLQYER, “EL MATADOR” TËRHIQET NGA FUTBOLLI

BUENOS AIRES, 29 DHJETOR - Futbollisti legjendar uruguaiian Edinson Cavani i ka dhënë fund karrierës së tij të shkëlqyer në moshën 38-vjeçare. Cavani ka njoftuar tërheqjen nga futbollit gjatë pushimit të kampionatit argjentinas, i cili zgjat nga 7 dhjetori deri në fund të janarit. Golashënuesi uruguaiian është përcjell me një mesazh prekës drejtuar futbollit. “Më ke

formuar, më ke sfiduar, më ke mësuar të ngrihem gjithmonë kur rrëzohem dhe të vlerësoj çdo hap gjatë rrugës. Më ke lejuar të arrij ëndrra që më dukeshin të pamundura si fëmijë dhe të takoj njerëz të jashtëzakonshëm si në fushë ashtu edhe jashtë saj. Asgjë nga kjo nuk do të kishte qenë e mundur pa familjen, miqtë, shokët e ekipit, trajnerët dhe, mbi të gjitha, njerëzit e mi.

Dashurinë e tifozëve në çdo vend dhe në çdo klub do ta mbaj me vete përgjithmonë. Po largohem në paqe, i qetë duke e ditur se dhashë gjithçka në çdo seancë stërvitore dhe në çdo ndeshje. Me gabime dhe suksese, por gjithmonë me respekt për këtë profesion që më ka dhënë kaq shumë”, ka shkruar Cavani në letrën e tij të lamtumirës. El Matador”, siç njihet Cavani, ka

veshur fanellën e Boca Juniorsit në dy vitet e gjysmë të fundit, ndërsa më parë ka fituar famë me PSG-në, Napolin, Palermon dhe Manchester Unitedin. Ai ka luajtur 301 ndeshje për PSG-në dhe ka shënuar 200 gola, ndërsa me Napolin ka realizuar 104 gola në 138 paraqitje. Me Kombëtaren e Uruguait, Cavani ka regjistruar 136 paraqitje dhe shënuar 58 gola.




Al Nassri i falet Ronaldos, hyn në histori të Arabisë

Riad, 29 dhjetor - Ndikimi i Cristiano Ronaldos tek Al Nassari është tejet i madh. Edhe pse 40-vjeçar, CR7 po lë gjurmë

në kampionatin arab të futbollit. Al Nassri në fundjavë ka shënuar një tjetër fitore, duke e mposhtur Al Okhdood, me rezultat 3-0, ku

portugezi ka shënuar dy gola, derisa kjo ishte fitorja e 10 në po aq ndeshje të këtij sezoni. Pikërisht kjo fitore ka bërë që Al

Nassri të hyjë në histori, duke u bërë skuadra e parë e cila fiton 10 ndeshjet e para radhazi në kampionatin arab.





KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe 12, bazuar në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, bazuar në Vendimin e datës 23/12/2025 me numër të protokollit 02/01/936 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i Vendit të punës:	Arkëtarë/e në Portoarkë
Nr. i kërkuar:	Një (1) pozitë, Selia Qendrore në KRM “Pastrimi” SH.A
Numri i Referencës:	KP/RR/SQ/40-2025
Arsimimi i kërkuar:	Shkollim i mesëm
Përvoja e punës e kërkuar:	1 vite përvojë pune
Koeficienti/Paga mujore:	Niveli XIV
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës:	Me kohë të pa caktuar
Periodha Provuese:	3 muaj

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Realizon pagesat në para të gatshme nga konsumatorët dhe kujdeset për numërimin dhe saktësinë e tyre;
- Të gjitha paratë të llogaritura mirë i dorëzon brenda ditës në bankën me të afërt apo sipas nevojës në arkën kryesore të kompanisë;
- Kujdeset për identifikimin e klientit, regjistrimin dhe numërimin e parave dhe regjistrimin e pagesave në kompjuter;
- Pranon informata të ndryshme dhe ankesat lidhur me problemet e konsumatorëve dhe për të njëjtat e njofton udhëheqësin e njësisë së thirrjeve dhe kujdesit për konsumator “Call Centre”;
- Përgatitë raportet e pagesave dhe të njëjtat menjëherë i dorëzon në shërbimin e kontabilitetit me qëllim të regjistrimit të pagesave;
- Bënë barazimin ditor të pazarit mes raportit të sistemit dhe mjeteve në dispozicion;
- Raportin e bankës si dëshmi që mjetet janë dorëzuar e dërgon në shërbimin përkatës të nënshkruar dhe të specifikuar sipas datave;
- Për secilën pagesë mban kopje si dëshmi të nënshkruara nga dy palët;
- Kujdeset për mjetet e pranuar duke i verifikuar me pajisje adekuate;
- Mbanë ditarin e arkës dhe materialin financiar në rregull dhe të gatshëm për regjistrim mujor;
- Bënë dorëzimin e raporteve në fund të orarit në baza ditore direkt në sistemin;
- Dërgon raportin të shefi të shërbimit për krahasim dhe kontroll të periodes;
- Kujdeset për raportet e përfunduara duke i rregulluar në dosje të caktuara. Obligohet të zbatoj strikt orarin e punës dhe nuk lejohet të mbyllet pika brenda orarit të punës;ryen punë dhe detyra të tjera sipas kërkesës së Udhëheqësit të Faturimit.
- Për punën raportin tek Udhëheqësi i Njesisë së Faturimit.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

3. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Dokument identifikimi e Republikës së Kosovës	✓
Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj	✓

5. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

5.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:

- * duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh. A.
- * në recepcionin e kompanisë.

5.2 Dorëzimi i aplikacionit:

- * Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
- * Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

6. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 29/12/2025 deri me datën 15/01/2026.
Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.
Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

7. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:

- ✓ Testit me shkrim: deri në 60 pikë
- ✓ CV-ja e kandidatit: deri në 10 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 30 pikë.

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronit dhe individualisht.

9. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Focus” SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811054387.
- Leonor Osmanaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.
- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sal-lon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpazj. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informa-ta lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

